



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

KA/Nr. 2908/20  
Datë: 23/11/2020

Komisioni i Ankesave në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, i themeluar me Vendimin Nr.1448/20D, ta datës 04.09.2020, në përbërje të Bujar Pira, Muhamet Qerimi dhe Krenare Sogojeva Dërmaku, në shqyrtimin e lëndës administrative, respektivisht ankesës Kolegjit Universum nr.prot.760/20H datë 07.07.2020, kundër Vendimit të KSHC Nr. 566/20D, të datës 22.06.2020 për refuzimin e akreditimit të programeve Gjuhë Angleze, BA, 180 ECTS; Fizioterapi, BA profesional, 180 ECTS; dhe Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS, e pranuar më datë 23.10.2020, në mbështetje të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e datës, 11.11.2020, me votim unanimit, mori këtë:

**VENDIM**

1. Pranohet pjesërisht si e bazuar ankesa e Kolegjit Universum, nr.prot.760/20H datë 07.07.2020 dhe shfuqizohet Vendimi i KSHC-së nr. 566/20D, të datës 22.06.2020.
2. Obligohet AKA që për programin Gazetari Digjitale, BA profesional, 180 ECST të vazhdojë me procedurat sipas dispozitave ligjore të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.15/2018 për akreditim të institucioneve të arsimit të lartë.

**ARSYETIM**

Kolegji Universum më datë 07.07.2020, brenda afatit ligjor ka parashtruar Ankesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, përmes së cilës ka kërkuar që Këshilli Shtetëror i Cilësisë të rishqyrtoj vendimin e tij të datës 22.06.2020, nr. 566/20D, me të cilin është refuzuar akreditimi i programeve Gjuhë Angleze, BA, 180 ECTS; Fizioterapi, BA profesional, 180 ECTS; dhe Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS. Pala me Ankesën e datës 07.07.2020 pretendon se:

Këshilli Shtetëror i Cilësisë pa të drejtë ka refuzuar kërkesën për akreditim të programit Gjuhë Angleze, ngase personat e paraqitur si bartës programit, janë të fushës dhe plotësojnë kriteret e neni 26, paragrafi 5.3.4 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve.

Po ashtu, pala ka pretenduar se refuzimi i programit Fizioterapi, BA profesional, 180 ECTS, dhe programit Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS, është i padrejtë derisa në të dyja programet personat e paraqitur si bartës të tyre janë të fushave përkatës dhe kanë ë përvojën e duhur profesionale.

#### **Provat e administruara:**

- Vendimi i KSHC-së Nr. 974/20D
- Lista e bartësve të programit Gjuhë Angleze me kualifikimet e tyre (Excel);
- Lista e bartësve të programit Fizioterapi me kualifikimet e tyre (Excel);
- Kontrata e punës së prof. Bekim Ramabaja;
- Kontratat e punës së profesorëve për programin Gazetari Digjitale;
- Raporti i KSHC-së për rishqyrtimin e ankesës nga takimi i datës 02.09.2020

#### **Shpjegim i situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi**

Komisioni i Ankesave pranë AKA-së, ka pranuar ankesën e datës 07.07.2020 të Kolegjit Universum me datë 23.10.2020, së bashku me dokumentacionin dhe raportin e KSHC-së nga takimi i datës 02.09.2020, me të cilën ka përshkruar pretendimin e palës dhe arsyen e refuzimit të kërkesës për akreditim të programeve Gjuhë Angleze, BA, 180 ECTS; Fizioterapi, BA profesional, 180 ECTS; dhe Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS.

Komisioni i Ankesave, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkëngjitura ka gjetur se:

KSHC për programin Gjuhë Angleze, BA, 180 ECTS, në të cilin Kolegji Universum ka paraqitur si bartës të programit ka paraparë: Jusuf Mustafai, Arsim Rexhepi, Mirian Zeneli dhe Martina Mastandrea. Sipas nenit 26 pika 5.3.4 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit.”*

Sipas kësaj, programi në fjalë duhet të ketë të paktën 3 staf akademik me gradë shkencore PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit. Pas verifikimit të dokumentacionit KSHC ka vërejtur se prof. Jusuf Mustafai është i deklaruar dy herë në platformën e-akreditimi në dy IAL të ndryshme si profesor me marrëdhënie të plotë të punës. Pos kësaj KShC ka konstatuar se prof. Martina Mastandrea nuk posedon nostrifikim të diplomës nga MASHT siç parashihet në UA 16/2016 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave të fituara jashtë Republikës së Kosovës. Kurse sa i përket profesorëve Arsim Rexhepi dhe Milaim Zeneli KShC ka konstatuar se diplomat e tyre nuk përkojnë me fushën e programit në fjalë. Bazuar në këtë KShC ka konstatuar se ky pretendim nuk ka bazë.

KSHC për programin Fizioterapi, BA profesional, 180 ECTS për të cilin Kolegji në fjalë ka paraqitur 5 bartës (Zana Gergi, Bekim Ramabaja, Sylejman Myftari, Kaltrina Abazi dhe Vesa

Rraci) ka konstatuar se Zana Gergi, Bekim Ramabaja dhe Sylejman Myftari janë të fushës. Nga 3 bartësit që plotësojnë kriterin e fushës së studimit të programit, Bekim Ramabaja nuk ka përvojë të mjaftueshme ngase i njëjti ka punuar në EULEX, por jo në profesionin e fizioterapeutit..

Ndërsa, për programin Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS, KSHC ka konstatuar se nga gjashtë (6) personat e paraqitur si bartës të programit (Arbenita Hoxha, Afet Bela, Venera Radoni, Lavdim Hamidi, Sami Shala, Dafina Haliti), vetëm Arbenita Hoxha plotëson kriteriet derisa të tjerët nuk kanë dëshmuar se kanë përvojë profesionale.

### **Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave**

Komisioni i Ankesave, pasi ka konstatuar se ankesa e Kolegjit Universum është parashtruar brenda afatit kohor, ka shqyrtuar pretendimet e palës për refuzimin e akreditimit të programeve Gjuhë Angleze, BA, 180 ECTS; Fizioterapi, BA profesional, 180 ECTS; dhe Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS.

Komisioni i Ankesave për programin Gjuhë Angleze, BA, 180 ECTS ka gjetur se nga katër (4) bartësit e programit të paraqitur nga Kolegji në fjalë, prof. Jusuf Mustafai është i deklaruar dy herë në platformën e-akreditimi në dy IAL të ndryshme si profesor me marrëdhënie të plotë të punës ndërsa prof. Martina Mastandrea nuk posedon nostrifikim të diplomës nga MASHT siç parashihet në UA 16/2016 për parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave të fituara jashtë Republikës së Kosovës dhe profesorët Arsim Rexhepi dhe Milaim Zeneli nuk janë të fushës së programit të studimit. Të gjitha këto Komisioni i Ankesave i ka vërtetuar nga Lista e bartësve të programit Gjuhë Angleze me kualifikimet e tyre (Excel) dhe nga platforma e e-akreditimit.

Komisioni i Ankesave për programin Fizioterapi, BA profesional, 180 ECTS ka gjetur se nga 3 bartësit e programit të paraqitur nga Kolegji Universum, të vërtetuar si të fushës nga KSHC, njëri prej tyre, respektivisht prof. Bekim Ramabaja nuk e plotëson kriterin e përvojës përkatëse të fushës, ngase i njëjti ka pasur kontratë në EULEX, por e cila nuk vërtetohet se ka ushtruar detyrën e fizioterapeutit. Për këtë, KSHC ka larguar nga lista e bartësve të programit, e me cka ky program ka mbetur me vetëm dy bartës që plotësojnë kriteret. Kjo është vërtetuar me kontratën e punës së prof. Ramabaja mnë EULEX dhe nga Lista e bartësve të Programit Fizioterapi me kualifikimet e tyre (Excel), si dhe platformën e-akreditimi.

Komisioni i Ankesave për Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS, ka gjetur se KSHC prej 6 personave të paraqitur nga Kolegji në fjalë ka hequr nga lista si bartës të programit, prof. Afet Bela, Venera Radoni, Lavdim Hamidi, Sami Shala, duke konstatuar se të njëjtit nuk kanë përvojën përkatëse të punës për të qenë bartës të programit.

Komisioni i Ankesave pasi ka bërë verifikimin në platformën e-akreditim, ka gjetur se Venera Radoni dhe Afet Bela kanë përvojë të mjaftueshme profesionale për të qenë bartës të programit Gazetari Digjitale.

## Baza ligjore e vendimit dhe arsyeja pse është e zbatueshme në rastin konkret

Me nenin 26 pika 5.3.4 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, është përcaktuar se: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit.”*

Komisioni i Ankesave ka vërtetuar se KSHC në vendimin e tij në përpikëri ka zbatuar këtë dispozitë ligjore për të tri programet e paraqitura nga Kolegji Universum për akreditim.

Po ashtu, Komisioni i Ankesave ka konstatuar se KSHC gjatë shqyrtimit të programeve në fjalë ka zbatuar nenin 10, paragrafin 1.2.1 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë me të cilën është përcaktuar e drejta e KSHC-së për të aprovuar listën e stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për akreditim nga institucionet e arsimit të lartë.

Komisioni i Ankesave për programin Gjuhë Angleze, BA, 180 ECTS pasi ka vërtetuar se nga katër (4) bartësit e programit të paraqitur, prof. Jusuf Mustafai është i deklaruar dy herë në platformën e-akreditimi në dy institucione të ndryshme si profesor me marrëdhënie të plotë të punës, konstaton se KSHC ka vepruar drejtë kur ka larguar të njëjtin nga lista e bartësve duke respektuar nenin 30, paragrafin 2 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, i cili përcakton se: *“Stafi akademik i cili ndryshon angazhimin brenda një viti akademik nuk do të pranohet nga AKA për qëllime të vlerësimit dhe akreditimit.”*

Komisioni i Ankesave për programin Fizioterapi, BA profesional, 180 ECTS ka gjetur se KSHC ka zbatuar nenin 27, paragrafin 5.1. të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, e ku është përcaktuar se *“Stafi për mësimdhënie duhet të jetë i kualifikuar në aspektin akademik dhe profesional, me përvojë së paku 5 vjeçare në fushën përkatëse, i zgjedhur në procedurë transparente” derisa ka vërtetuar se prof. Bekim Ramabaja nuk plotëson kriterin e përvojës përkatëse të fushës, ngase i njëjti ka pasur kontratë në EULEX, por e cila nuk vërteton se ka ushtruar detyrën e fizioterapisë.*

Komisioni i Ankesave për programin Gazetari Digjitale, BA Profesional, 180 ECTS, ka gjetur se KSHC nuk ka vërtetuar saktë gjendjen faktike për sa i përket zbatimit të nenin 27, paragrafin 5.1. të Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.15/2018 për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë ku është përcaktuar se *“Stafi për mësimdhënie duhet të jetë i kualifikuar në aspektin akademik dhe profesional, me përvojë së paku 5 vjeçare në fushën përkatëse, i zgjedhur në procedurë transparente” , respektivisht ka konstatuar gabimisht faktet kur ka vendosur se Venera Radoni dhe Afet Bela nuk kanë përvojë të mjaftueshme profesionale për të qenë bartës të programit Gazetari Digjitale, ngase është vërtetuar se të njëjtit kanë përvojën e kërkuar sipas nenit 27, paragrafit 5.1 të Udhëzimit të lartcekur.*

Pala me datë 29.10.2020, ka qenë e ftuar nga Komisioni i Ankesave për ta ushtruar të drejtën e vet për tu dëgjuar, ashtu siç e parashih nënin 95 i Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Kolegji Universum e ka realizuar këtë të drejtë dhe ka mbrojtur të njëjtat pretendime si në ankesë.


Në përfundim,

Komisioni i Ankesave pasi shqyrtimit dhe administrimit të provave, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi, mbi bazën e kompetencave të dhëna me nenin 22, paragrafin 3 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Komisioni i Ankesave në AKA

KA/Nr. 2908/20, datë 23/11/2020

Procesmbajtësi

  
Arianit Krasniqi

Kryetari i Komisionit të Ankesave

  
Faton Merovci



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditëve në gjykatën kompetente për konfliktet administrative.